

VENDIM
Nr. 251, datë 29.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 7, DATË 11.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2017 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshon dhe bëhet "...2 375 punonjës."

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në ndarjet "Gr. 10, Ministria e Financave", "Gr. 14, Ministria e Drejtësisë", "Gr. 94, Ministria e Zhvillimit Urban", dhe "Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare", shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Pas ndarjes "Gr. 94, Ministria e Zhvillimit Urban", shtohet ndarja "Gr. 95, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Periudha kohore për emërtesën "operatorë", në ndarjen "Gr. 14, Ministria e Drejtësisë", bëhet 6-mujore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
10	Ministria e Financave	1			
	Drejtoria e Apelit Tatimor	1	Punonjës Protokolli	8 orë/ditë	6 muaj
14	Ministria e Drejtësisë	1			
	Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimit të Proves	1	Sanitar	6 orë/ditë	mars-dhjetor
87	Institucionet e tjera qeveritare	1			
	Agjensia për Zhvillim Rajonal 3, Korçë	1	Sanitar	6 orë/ditë	mars-dhjetor
94	Ministria e Zhvillimit Urban	100			
	Drejtoritë Rajonale ALUIZNI	80	Specialistë	8 orë/ditë	mars-dhjetor
	Drejtoritë Rajonale ALUIZNI	20	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	mars-dhjetor
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	2			
	Aparatit institucionit	1	Sanitar	6 orë/ditë	mars-dhjetor
	Aparatit institucionit	1	Teknikë të mesëm	6 orë/ditë	mars-dhjetor
	TOTAL SHITESA PËR PUNONJËS ME KONTRATË	105			

